



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.3, datë 08.11.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE”
SUBJEKTIT “ADG”

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit uJOR, e lejes/autorizimit për përdorim burimi uJOR, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit uJOR, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit UJOR Seman,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi uJOR nëntokësor për qëllime industriale, subjektit “ADG”, me vendndodhje Njësia Administrative Kolonjë Lushnje Qarku Fier.
2. Uji i marrë nga pusi egzistues nuk mund të përdoret për përpunimin e qumështit dhe në industrinë ushqimore.
3. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- X= 470884.06; Y= 4525785.68; Z= 20 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shfrytëzimit sipas KRGJSH

- $X= 470947.711$; $Y= 4525818.42$; $Z= 21$ m.m.n.d

-

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shkarkimit sipas KRGJSH

- $X= 470730.5558$; $Y= 4525825.943$; $Z= 25$ m.m.n.d

- Prurja e kërkuar: $Q= 1.6$ l/sek

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

